REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E EKONOMISË DHE INOVACIONIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME E METROLOGJISË

Nr. 2463 Prot. Tiranë, më 13. 10. 2026

STRATEGJIA E MENAXHIMIT TË RISKUT PËR DREJTORINË E PËRGJITHSHME TË METROLOGJISË

MIRATOHET
DREJTOR I PËRGJITHSHËM
Alkida Llaka

KAPITULLI I

POLITIKA E MENAXHIMIT TË RISKUT

I.1. Deklarata e politikës së menaxhimit të riskut

Drejtoria e Përgjithshme e Metrologjisë angazhohet të krijojë dhe të mbajë një sistem efektiv të menaxhimit të riskut, nëpërmjet të cilit risqet identifikohen, vlerësohen, dokumentohen dhe trajtohen në kohën e duhur.

Politika e menaxhimit të riskut mbështetet në parimet e ligjshmërisë, përgjegjshmërisë, transparencës, proporcionalitetit dhe përmirësimit të vazhdueshëm.

DPM synon që menaxhimi i riskut:
- Të integrohet në proceset e planifikimit dhe vendimmarrjes.
- Të mbështesë realizimin e objektivave strategjikë dhe operacionalë.
- Të përmirësojë administrimin e burimeve financiare, njerëzore dhe materiale.
- Të rrisë ndërgjegjësimin e punonjësve për përgjegjësitë që lidhen me riskun.
- Të sigurojë raportimin dhe trajtimin në kohë të problematikave.
- Të kontribuojë në përmirësimin e cilësisë dhe besueshmërisë së shërbimeve të metrologjisë.

I.2. Qëllimi i politikës së menaxhimit të riskut

Qëllimi i politikës është identifikimi i fushave të ekspozuara ndaj riskut, vlerësimi i probabilitetit dhe ndikimit të tij dhe përcaktimi i masave për shmangien, reduktimin ose mbajtjen e tij në një nivel të pranueshëm.

Menaxhimi i riskut lidhet me kërcënimet dhe mundësitë që mund të ndikojnë në krijimin, ruajtjen dhe shtimin e vlerave institucionale.

Për qëllimet e kësaj Strategjie, risku kuptohet si efekti i pasigurisë mbi realizimin e objektivave të institucionit, ndërsa menaxhimi i riskut përfshin proceset e koordinuara për identifikimin, vlerësimin, trajtimin dhe monitorimin e tij.

I.3. Objektivat e Strategjisë

Objektivat e Strategjisë së Menaxhimit të Riskut janë:

1. Rritja e nivelit të ndërgjegjësimit të punonjësve për menaxhimin e riskut.
2. Identifikimi dhe dokumentimi i risqeve që mund të ndikojnë në realizimin e objektivave të DPM.
3. Përcaktimi i qartë i përgjegjësive për administrimin e risqeve.
4. Vlerësimi sistematik i probabilitetit dhe ndikimit të risqeve.
5. Përcaktimi i masave të përshtatshme të kontrollit dhe trajtimit.
6. Monitorimi periodik i efektivitetit të masave të zbatuara.
7. Përmirësimi i cilësisë së informacionit që përdoret për vendimmarrje.
8. Sigurimi i përdorimit efektiv dhe të përgjegjshëm të burimeve publike.
9. Nxitja e identifikimit dhe shfrytëzimit të mundësive për përmirësimin e veprimtarisë institucionale.

I.4. Parimet e menaxhimit të riskut

Menaxhimi i riskut në DPM mbështetet në parimet e mëposhtme:

- **Krijimi dhe mbrojtja e vlerave:** menaxhimi i riskut kontribuon në realizimin e objektivave dhe në mbrojtjen e interesit publik.
- **Integrimi organizativ:** menaxhimi i riskut është pjesë e proceseve dhe veprimtarive të institucionit.
- **Mbështetja e vendimmarrjes:** vendimet merren duke marrë në konsideratë risqet dhe mundësitë përkatëse.
- **Trajtimi i pasigurisë:** risqet identifikohen dhe vlerësohen në mënyrë sistematike.
- **Përdorimi i informacionit të besueshëm:** vendimmarrja mbështetet në informacionin më të saktë dhe të disponueshëm.
- **Përgjegjësia e përbashkët:** çdo punonjës kontribuon në identifikimin dhe raportimin e risqeve që lidhen me detyrat e tij.
- **Proporcionaliteti:** masat e kontrollit përshtaten me nivelin dhe natyrën e riskut.
- **Përmirësimi i vazhdueshëm:** proceset dhe kontrollet rishikohen për të rritur efektivitetin e tyre.

I.5. Kuadri ligjor dhe rregullator

Strategjia e Menaxhimit të Riskut hartohet dhe zbatohet në përputhje me legjislacionin në fuqi të Republikës së Shqipërisë, aktet nënligjore përkatëse dhe rregullat e brendshme të institucionit.

Baza ligjore përfshin:

1. **Ligjin nr. 10296, datë 8.7.2010, "Për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin", të ndryshuar**, i cili përcakton kuadrin e përgjegjësive dhe kërkesat për funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit në njësitë publike.

2. **Ligjin nr. 126/2020, "Për metrologjinë"**, i ndryshuar.
3. **Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 325, datë 18.5.2022**, "Për organizimin dhe funksionimin e Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë".
4. **Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 16, datë 31.12.2024**, "Për përgjegjësitë dhe detyrat lidhur me koordinimin e menaxhimit financiar dhe kontrollit dhe funksionimin e grupit të menaxhimit të risqeve në njësitë publike".
5. **Ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008, "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar**, për aspektet që lidhen me planifikimin, administrimin dhe kontrollin e fondeve buxhetore.
6. Aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi për administrimin e aktiveve publike, kontabilitetin dhe raportimin financiar, etikën, organizimin e administratës publike dhe kontrollin e brendshëm.
7. Rregulloren e brendshme të DPM, procedurat administrative dhe financiare, si dhe aktet e brendshme të miratuara për ushtrimin e funksioneve institucionale.

Zbatimi i kësaj Strategjie bëhet në përputhje me versionet në fuqi të akteve ligjore dhe nënligjore. Në rast të ndryshimeve të kuadrit ligjor, dokumenti rishikohet dhe përditësohet sipas nevojës.

KAPITULLI II

PROCESI I MENAXHIMIT TË RISKUT

II.1. Ecuria e procesit të menaxhimit të riskut

DPM ka përcaktuar objektiva institucionale, realizimi i të cilave kërkon planifikim të kujdesshëm, administrim efektiv të burimeve dhe monitorim të vazhdueshëm të veprimtarive.

Menaxhimi i riskut realizohet nëpërmjet një procesi të koordinuar, i cili përfshin përcaktimin e objektivave, identifikimin e risqeve, analizimin dhe vlerësimin e tyre, përcaktimin e masave të trajtimit, zbatimin e kontrolleve, monitorimin dhe raportimin.

Çdo risk karakterizohet nga natyra, shkaqet, probabiliteti i ndodhjes dhe ndikimi i mundshëm. Vlerësimi i këtyre elementeve mundëson përcaktimin e prioriteteve dhe shpërndarjen e burimeve sipas nivelit të ekspozimit.

Menaxhimi efektiv i riskut ndihmon në:
- Rritjen e sigurisë për arritjen e rezultateve të synuara.
- Trajtimin e kërcënimeve në mënyrë efektive.
- Marrjen e vendimeve të informuara.
- Identifikimin e mundësive për përmirësim.
- Reduktimin e humbjeve financiare dhe operacionale.
- Rritjen e qëndrueshmërisë së veprimtarisë institucionale.

Procesi i menaxhimit të riskut përshtatet me natyrën dhe kompleksitetin e secilit risk. Për këtë arsye, masat e trajtimit dhe shpeshtësia e monitorimit mund të ndryshojnë sipas nivelit të riskut.

II.2. Parakushtet për zbatimin e politikës

Zbatimi efektiv i politikës së menaxhimit të riskut kërkon përmbushjen e këtyre parakushteve:

1. Drejtuesit monitorojnë dhe verifikojnë periodikisht risqet që mund të cenojnë realizimin e objektivave strategjikë dhe operacionalë.
2. Personat përgjegjës zotërojnë njohuritë dhe aftësitë e nevojshme për identifikimin, analizimin dhe vlerësimin e risqeve.
3. Punonjësit trajnohen për përdorimin e metodologjisë së menaxhimit të riskut.
4. Përgjegjësitë për identifikimin, raportimin dhe trajtimin e risqeve përcaktohen qartë.
5. Punonjësit raportojnë në kohë ngjarjet, problematikat dhe ndryshimet që mund të ndikojnë në realizimin e objektivave.
6. Drejtuesit mbështesin masat e arsyetuara për reduktimin e riskut, në përputhje me kompetencat dhe procedurat në fuqi.
7. Regjistri i Riskut mbahet i përditësuar dhe përdoret si instrument aktiv i vendimmarrjes dhe monitorimit.

II.3. Komponentët e menaxhimit të riskut institucional

Menaxhimi i riskut institucional përfshin tetë komponentë të ndërlidhur:

- Mjedisi i kontrollit.
- Përcaktimi i objektivave.
- Identifikimi i ngjarjeve dhe risqeve.
- Vlerësimi i risqeve.
- Reagimi ndaj risqeve.
- Veprimtaritë e kontrollit.
- Informimi dhe komunikimi.
- Monitorimi.

Mjedisi i kontrollit përfshin kulturën organizative, integritetin, vlerat etike, strukturën dhe përgjegjësitë e institucionit.

Përcaktimi i objektivave siguron që risqet të identifikohen në lidhje të drejtpërdrejtë me rezultatet që synon të arrijë DPM.

Identifikimi i ngjarjeve përfshin evidentimin e faktorëve të brendshëm dhe të jashtëm që mund të ndikojnë në objektivat institucionale, duke dalluar kërcënimet nga mundësitë.

Vlerësimi i risqeve bazohet në analizën e probabilitetit të ndodhjes dhe ndikimit të mundshëm.

Reagimi ndaj risqeve përfshin zgjedhjen e masave të përshtatshme, si shmangia, reduktimi, pranimi ose transferimi i riskut.

Veprimtaritë e kontrollit sigurojnë zbatimin e politikave dhe procedurave të përcaktuara për trajtimin e risqeve.

Informimi dhe komunikimi sigurojnë që informacioni i nevojshëm t'u përcillet personave përgjegjës në kohën e duhur.

Monitorimi vlerëson nëse sistemi i menaxhimit të riskut dhe masat e kontrollit funksionojnë në mënyrë efektive.

II.4. Objektivat strategjikë të DPM

Menaxhimi i riskut lidhet drejtpërdrejt me misionin, vizionin dhe objektivat strategjikë të DPM.

Objektivat strategjikë të përcaktuar në dokumentin bazë janë:
1. **Objektivi nr. 1:** Zgjerimi i njohjeve ndërkombëtare të DPM.
2. **Objektivi nr.2:** Realizimi i gjurmueshmërisë së matjeve në nivelin më të lartë ndërkombëtar.
3. **Objektivi nr. 3:** Rritja e shkallës së mbrojtjes së konsumatorëve.

Identifikimi dhe trajtimi i risqeve që lidhen me këta objektiva duhet të mbështesë planifikimin e veprimtarive, përdorimin efektiv të burimeve dhe rritjen e cilësisë së shërbimeve të ofruara nga institucioni.

II.5. Identifikimi i riskut

Risku është mundësia e ndodhjes së një ngjarjeje që mund të ndikojë në realizimin e objektivave të institucionit.

Identifikimi i riskut është hapi i parë në krijimin e profilit të riskut të DPM. Ai synon evidentimin e ngjarjeve, kushteve dhe faktorëve që mund të shkaktojnë vonesa, humbje, dëme, mosrealizim objektivash ose ulje të cilësisë së shërbimeve.

Procesi i identifikimit duhet të jetë i vazhdueshëm, në mënyrë që të evidentohen:
- Risqe të reja që nuk janë identifikuar më parë.
- Ndryshime në probabilitetin ose ndikimin e risqeve ekzistuese.
- Risqe që nuk janë më të rëndësishme për veprimtarinë institucionale.
- Mundësi të reja për përmirësimin e proceseve dhe rezultateve.

Identifikimi mbështetet në analizën e përvojës së kaluar, raporteve vjetore, gjetjeve të kontrolleve, problematikave të konstatuara, raporteve të brendshme dhe zhvillimeve të pritshme politike, ekonomike, teknologjike e institucionale.

Risqet klasifikohen sipas burimit të tyre në:
a) Risqe të jashtme

Përfshijnë faktorët që burojnë nga ndryshimet ekonomike, politike, ligjore, teknologjike ose nga zhvillimet në mjedisin e jashtëm, të cilat mund të ndikojnë në realizimin e objektivave të DPM.

b) Risqe të brendshme

Përfshijnë faktorët që lidhen me organizimin dhe funksionimin e institucionit, burimet financiare, personelin, kompetencat profesionale, proceset administrative, sistemet e informacionit dhe procedurat e kontrollit.

Për çdo risk të identifikuar dokumentohen, sipas rastit, përshkrimi, shkaqet, pasojat e mundshme, objektivi i prekur, zotëruesi i riskut dhe masat ekzistuese të kontrollit.

II.6. Vlerësimi i riskut

Vlerësimi i riskut synon përcaktimin e nivelit të ekspozimit dhe renditjen e risqeve sipas rëndësisë së tyre.

Vlerësimi mbështetet në tri parime:
1. Përdorimi i një procesi të qartë dhe të dokumentuar.
2. Regjistrimi i rezultateve për të lehtësuar monitorimin dhe përcaktimin e prioriteteve.
3. Dallimi ndërmjet riskut të qenësishëm dhe riskut të mbetur.

Risku i qenësishëm është niveli i riskut përpara zbatimit të kontrolleve, ndërsa risku i mbetur është niveli që vazhdon të ekzistojë pas zbatimit të masave të kontrollit.

Për vlerësimin e risqeve përdoren dy kritere kryesore:
- **Probabiliteti:** mundësia që ngjarja të ndodhë.
- **Ndikimi:** pasojat që mund të ketë ngjarja në realizimin e objektivave.

Për qëllime të kësaj Strategjie, niveli i riskut klasifikohet në të ulët, të mesëm dhe të lartë.

Niveli	**Përshkrimi**	**Qasja e trajtimit**
I ulët	Probabilitet dhe ndikim relativisht i kufizuar	Monitorim dhe kontrolle rutinë
I mesëm	Mundësi ose pasoja që kërkojnë vëmendje të shtuar	Masa të përcaktuara dhe monitorim periodik
I lartë	Mundësi ose pasoja të rëndësishme për objektivat	Veprime prioritare, përgjegjësi të qarta dhe monitorim i shpeshtë

Klasifikimi konkret bëhet sipas metodologjisë dhe kritereve të miratuara nga institucioni. Kur është e mundur, vlerësimi mbështetet edhe në të dhëna financiare ose tregues të matshëm.

Pas vlerësimit, risqet regjistrohen në Regjistrin e Riskut, ku përcaktohen zotëruesi i riskut, masat ekzistuese, veprimet e planifikuara dhe afatet e zbatimit.

Në dokumentin bazë të DPM përmenden gjithsej gjashtë risqe si më poshtë;
1. **Fonde të pamjaftueshme për likuidimin e kuotave të anëtarësimit** në organizatat ndërkombëtare, të nevojshme për arritjen e transmetueshmërisë së matjeve.
2. **Mungesë fondesh për kualifikimin e stafit dhe pjesëmarrjen në testet e zotësisë**, të nevojshme për procesin e akreditimit të laboratorëve.
3. **Mosakreditimi i laboratorëve të DPM**, si pasojë e pamundësisë për kalibrimin e pajisjeve për shkak të vështirësive në procedurat e prokurimit.

4. **Pamundësia për kalibrimin e etaloneve referuese** për fushat e matjes, për shkak të fondeve të pamjaftueshme.
5. **Mungesa e stafit për periudha të gjata kohore**, për shkak të vendeve vakante të metrologëve të autorizuar dhe specialistëve në zona të caktuara të vendit, duke sjellë moskryerjen e rreth 41 300 verifikimeve të instrumenteve matëse që i nënshtrohen kontrollit ligjor.
6. **Mosakreditimi i laboratorëve të DPM**, për shkak të mosdisponueshmërisë së vlerësuesve të jashtëm dhe vështirësive në gjetjen e vlerësuesve për fushat përkatëse.

Identifikimi dhe përshkrimi i plotë i tyre pasqyrohet në regjistrin përkatës, duke ruajtur të dhënat e vlerësimit dhe masat e miratuara.

II.7. Adresimi dhe trajtimi i riskut

Qëllimi i trajtimit të riskut është reduktimi i ekspozimit në një nivel të pranueshëm, mbrojtja e objektivave institucionale dhe shfrytëzimi i mundësive për përmirësim.

Për çdo risk përcaktohet alternativa më e përshtatshme e trajtimit, duke marrë në konsideratë nivelin e riskut, burimet në dispozicion, koston e masave dhe ndikimin e pritshëm.

1. Pranimi i riskut

Risku mund të pranohet kur niveli i tij është i ulët ose kur kostot e masave shtesë tejkalojnë përfitimin e pritshëm. Vendimi duhet të mbështetet në vlerësim të dokumentuar dhe të jetë në përputhje me kompetencat përkatëse.

2. Reduktimi i riskut

Përfshin zbatimin e kontrolleve dhe masave që synojnë uljen e probabilitetit të ndodhjes ose kufizimin e pasojave të riskut. Kjo është një nga alternativat kryesore të trajtimit në DPM.

3. Transferimi i riskut

Për disa risqe, ekspozimi mund të reduktohet nëpërmjet marrëveshjeve, sigurimeve ose mekanizmave të tjerë të ligjshëm me palë të treta. Transferimi nuk e përjashton institucionin nga përgjegjësia për mbikëqyrjen e marrëdhënies përkatëse.

4. Shmangia e riskut

Nënkupton heqjen dorë nga një veprimtari kur risku është i papranueshëm dhe nuk mund të menaxhohet në mënyrë efektive. Kjo alternativë merret në konsideratë sipas natyrës së veprimtarisë dhe detyrimeve ligjore të institucionit.

5. Shfrytëzimi i mundësive

Përfshin identifikimin dhe përdorimin e mundësive që mund të përmirësojnë rezultatet, rrisin efektivitetin dhe kontribuojnë në realizimin e objektivave strategjikë.

Masat e trajtimit dokumentohen në Regjistrin e Riskut dhe për secilën përcaktohen personi përgjegjës, afati i zbatimit dhe mënyra e verifikimit të efektivitetit.

II.8. Veprimtaritë e kontrollit

Veprimtaritë e kontrollit janë politika, procedura dhe masa që ndihmojnë në parandalimin, zbulimin dhe korrigjimin e ngjarjeve të padëshiruara.

Kontrollet duhet të zbatohen në të gjitha nivelet e institucionit dhe të jenë proporcionale me natyrën dhe nivelin e riskut.

A. Kontrollet parandaluese

Synojnë parandalimin e ngjarjeve të padëshiruara përpara se ato të ndodhin.

Shembuj:
- Ndarja e detyrave dhe përgjegjësive.
- Kufizimi i veprimeve për personat e autorizuar.
- Trajnimi dhe kualifikimi i punonjësve.
- Miratimi paraprak i shpenzimeve dhe veprimeve administrative.
- Zbatimi i rregulloreve dhe procedurave të brendshme.

B. Kontrollet zbuluese

Synojnë evidentimin në kohë të parregullsive, gabimeve dhe devijimeve nga procedurat e përcaktuara.

Shembuj:
- Inventarizimi periodik i aktiveve.
- Verifikimi i dokumentacionit dhe transaksioneve financiare.
- Monitorimi i zbatimit të procedurave.
- Kontrolli i rezultateve dhe raportimi i devijimeve.
- Rishikimi i veprimtarive pas përfundimit të tyre.

C. Kontrollet korrigjuese

Synojnë korrigjimin e problematikave të konstatuara dhe kufizimin e pasojave të tyre.

Shembuj:
- Korrigjimi i gabimeve financiare dhe administrative.
- Rikuperimi i shumave të paguara gabim, kur lejohet nga legjislacioni.
- Zbatimi i masave për korrigjimin e shkeljeve.
- Përmirësimi i procedurave për të shmangur përsëritjen e problematikave.

Kontrollet buxhetore dhe financiare

DPM zbaton kontrolle buxhetore dhe kontabël për të siguruar që shpenzimet të jenë të autorizuara, të dokumentuara dhe të regjistruara saktë.

Përdorimi i buxheteve, respektimi i limiteve të miratuara dhe verifikimi i dokumentacionit ndihmojnë në kufizimin e gabimeve, parregullsive dhe mundësive për mashtrim.

Efektiviteti i kontrolleve vlerësohet periodikisht dhe masat përkatëse përditësohen sipas ndryshimeve në profilin e riskut.

II.9. Rishikimi dhe raportimi i risqeve

Rishikimi dhe raportimi janë elemente të domosdoshme për monitorimin e ndryshimeve në profilin e riskut dhe vlerësimin e efektivitetit të masave të kontrollit.

Procesi i rishikimit duhet të përcaktojë:
- Nëse risku vazhdon të ekzistojë.
- Nëse probabiliteti ose ndikimi ka ndryshuar.
- Nëse masat e kontrollit janë efektive.
- Nëse janë shfaqur risqe të reja.
- Nëse nevojiten masa shtesë ose ndryshime në trajtim.
- Nëse afatet dhe përgjegjësitë janë respektuar.

Proceset e menaxhimit të riskut rishikohen të paktën një herë në vit, ndërsa risqet me ndikim të lartë monitorohen më shpesh, sipas nevojës.

Rezultatet e rishikimit dokumentohen dhe përdoren për përditësimin e Regjistrit të Riskut, raportimin te strukturat përgjegjëse dhe përmirësimin e masave të kontrollit.

II.10. Informimi dhe komunikimi

Informimi dhe komunikimi sigurojnë që informacioni për risqet të jetë i saktë, i plotë, i kuptueshëm dhe i disponueshëm në kohën e duhur.

Informacioni për menaxhimin e riskut përfshin:
Të dhënat historike, të cilat mundësojnë vlerësimin e rezultateve të mëparshme, identifikimin e mangësive dhe evidentimin e problematikave të përsëritura.
Të dhënat aktuale, të cilat pasqyrojnë gjendjen e risqeve dhe ndryshimet që mund të ndikojnë në realizimin e objektivave.
Të dhënat për të ardhmen, të cilat ndihmojnë në identifikimin e zhvillimeve dhe risqeve të mundshme në periudhat e ardhshme.

Çdo punonjës duhet të njihet me rolin dhe përgjegjësitë e tij në menaxhimin e riskut. Drejtuesit sigurojnë që informacioni për risqet t'u përcillet strukturave përgjegjëse dhe që raportimet të trajtohen në kohë.

II.11. Monitorimi dhe përmirësimi i vazhdueshëm

Monitorimi synon të vlerësojë nëse sistemi i menaxhimit të riskut funksionon sipas kërkesave të përcaktuara dhe nëse kontrollet japin rezultatet e pritshme.

Monitorimi realizohet nëpërmjet:
- Rishikimit të Regjistrit të Riskut.
- Verifikimit të zbatimit të masave dhe afateve.
- Analizës së raporteve të strukturave përgjegjëse.
- Vlerësimit të problematikave dhe mangësive të konstatuara.
- Propozimit të masave korrigjuese dhe parandaluese.

Rezultatet e monitorimit përdoren për përmirësimin e vazhdueshëm të procedurave, përditësimin e vlerësimeve dhe rritjen e efektivitetit të sistemit të kontrollit të brendshëm.

KAPITULLI III

ROLI DHE PËRGJEGJËSITË INSTITUCIONALE

III.1. Përgjegjësitë e Drejtorit të Përgjithshëm

Drejtori i Përgjithshëm, në përputhje me kompetencat ligjore, përgjigjet për drejtimin e institucionit dhe për krijimin e kushteve të nevojshme për funksionimin efektiv të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, përfshirë menaxhimin e riskut.

Në këtë kuadër, Drejtori i Përgjithshëm:
- Miraton Strategjinë e Menaxhimit të Riskut dhe ndryshimet e saj.
- Siguron integrimin e menaxhimit të riskut në proceset e planifikimit dhe vendimmarrjes.
- Mbikëqyr trajtimin e risqeve me rëndësi të veçantë për realizimin e objektivave institucionale.
- Siguron që strukturat përgjegjëse të kenë burimet dhe mbështetjen e nevojshme për zbatimin e masave të miratuara.
- Shqyrton raportimet për risqet prioritare dhe kërkon marrjen e masave korrigjuese, sipas rastit.
- Nxit kulturën e përgjegjshmërisë, komunikimit dhe raportimit në kohë të risqeve.

III.2. Përgjegjësitë e nëpunësit zbatus

Nëpunësi zbatus ushtron përgjegjësitë që i përcakton legjislacioni në fuqi për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe për koordinimin e proceseve përkatëse të menaxhimit të riskut.

Në kuadër të kësaj Strategjie, ai:
- Koordinon procesin e menaxhimit të riskut në përputhje me detyrat ligjore.
- Siguron bashkërendimin e punës ndërmjet strukturave përgjegjëse.
- Ndjek hartimin dhe përditësimin e Regjistrit të Riskut.
- Siguron që risqet prioritare të dokumentohen dhe të trajtohen në kohën e duhur.
- Informon drejtusin e institucionit për problematikat që kërkojnë ndërhyrje.

- Ushtron ose delegon detyrat përkatëse vetëm në përputhje me kushtet dhe procedurat e parashikuara nga legjislacioni.

III.3. Përgjegjësitë e Grupit të Menaxhimit Strategjik

Grupi i Menaxhimit Strategjik (GMS) kontribuon në shqyrtimin e çështjeve strategjike të institucionit dhe në vlerësimin e risqeve që mund të ndikojnë në realizimin e objektivave.

Në këtë kuadër, GMS:
- Shqyrton risqet kryesore institucionale dhe ndikimin e tyre në objektivat strategjikë.
- Analizon informacionin e paraqitur nga drejtoritë dhe sektorët.
- Vlerëson nëse masat e propozuara për trajtimin e risqeve janë të përshtatshme.
- Identifikon nevojën për ndryshime në prioritetet dhe masat e menaxhimit të riskut.
- Propozon përmirësime në proceset e menaxhimit financiar dhe kontrollit.
- Ndjek çështjet që kërkojnë koordinim ndërmjet disa strukturave të institucionit.

Përbërja, organizimi dhe funksionimi i grupit përcaktohen në përputhje me aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi.

III.4. Përgjegjësitë e koordinatorit të riskut

Koordinatori i riskut ushtron detyrat që i janë caktuar sipas legjislacionit dhe akteve të brendshme të institucionit.

Në varësi të përcaktimeve përkatëse, detyrat e tij përfshijnë:
- Koordinimin e procesit të identifikimit dhe vlerësimit të risqeve.
- Mbështetjen metodologjike të drejtorive dhe sektorëve.
- Administrimin dhe konsolidimin e informacionit të regjistrave të riskut.
- Ndjekjen e përditësimit të Regjistrit të Riskut.
- Përgatitjen e informacionit për raportimin periodik.
- Evidentimin e risqeve të reja dhe të ndryshimeve në risqet ekzistuese.
- Ndjekjen e zbatimit të masave të përcaktuara, në bashkëpunim me zotëruesit e risqeve.

Koordinatori i riskut nuk zëvendëson përgjegjësinë e drejtuesve të strukturave për risqet që lidhen me fushat e tyre të veprimtarisë.

III.5. Përgjegjësitë e drejtuesve të drejtorive dhe sektorëve

Drejtuesit e drejtorive dhe sektorëve janë përgjegjës për identifikimin dhe administrimin e risqeve që lidhen me funksionet dhe proceset nën përgjegjësinë e tyre.

Ata duhet të:
- Identifikojnë risqet që mund të pengojnë realizimin e objektivave të strukturës.
- Vlerësojnë probabilitetin dhe ndikimin e risqeve.
- Përcaktojnë dhe propozojnë masat e përshtatshme të kontrollit.
- Caktojnë personat përgjegjës për zbatimin e masave, sipas kompetencave.
- Monitorojnë realizimin e masave dhe respektimin e afateve.
- Raportojnë ndryshimet në profilin e riskut.

- Propozojnë përditësimin e Regjistrit të Riskut.
- Sigurojnë që punonjësit e strukturës të njohin përgjegjësitë e tyre në menaxhimin e riskut.

III.6. Përgjegjësitë e punonjësve

Çdo punonjës i DPM kontribuon në menaxhimin e riskut nëpërmjet zbatimit të procedurave, ruajtjes së dokumentacionit dhe raportimit të problematikave që mund të ndikojnë në realizimin e detyrave.

Punonjësit janë përgjegjës për:
- Zbatimin e akteve ligjore, rregulloreve dhe procedurave të brendshme.
- Identifikimin dhe raportimin në kohë të risqeve.
- Njoftimin e drejtuesve për ngjarjet e padëshiruara dhe mangësitë e konstatuara.
- Bashkëpunimin në zbatimin e masave të kontrollit.
- Pjesëmarrjen në trajnimet për menaxhimin e riskut.
- Ruajtjen dhe përdorimin e përgjegjshëm të burimeve publike.

Raportimi i një risku ose problemi duhet të trajtohet si pjesë e përgjegjësisë profesionale dhe si kontribut në përmirësimin e veprimtarisë së institucionit.

III.7. Regjistri i Riskut dhe detyrimi për përditësim

Regjistri i Riskut është dokumenti kryesor për evidentimin, vlerësimin, trajtimin dhe monitorimin e risqeve të institucionit.

Çdo drejtori dhe sektor duhet të kontribuojë në identifikimin dhe dokumentimin e risqeve që lidhen me fushën e vet të veprimtarisë.

Regjistri rishikohet dhe përditësohet të paktën një herë në vit dhe sa herë që ndodhin ndryshime të rëndësishme që mund të ndikojnë në profilin e riskut.

Për çdo risk duhet të dokumentohen, sipas rastit:
- Përshkrimi i riskut.
- Shkaqet dhe pasojat e mundshme.
- Objektivi ose procesi i prekur.
- Probabiliteti dhe ndikimi.
- Niveli i riskut të qenësishëm.
- Kontrollet ekzistuese.
- Masat shtesë të planifikuara.
- Zotëruesi i riskut.
- Afati i zbatimit.
- Niveli i riskut të mbetur.
- Statusi i masave dhe data e rishikimit.

Regjistrat e strukturave konsolidohen në nivel institucional, në mënyrë që drejtimi të ketë një pamje të përgjithshme të risqeve kryesore dhe të mund të përcaktojë prioritetet përkatëse.

KAPITULLI IV

ZBATIMI, RAPORTIMI DHE RISHIKIMI I STRATEGJISË

IV.1. Zbatimi i Strategjisë

Strategjia zbatohet nga të gjitha strukturat e DPM, në përputhje me funksionet dhe përgjegjësitë e tyre.

Zbatimi përfshin:

1. Informimin e punonjësve për përmbajtjen dhe kërkesat e Strategjisë.
2. Identifikimin dhe vlerësimin e risqeve në nivel drejtorie dhe sektori.
3. Përgatitjen dhe përditësimin e regjistrave të riskut.
4. Përcaktimin e masave të kontrollit dhe të përgjegjësive përkatëse.
5. Monitorimin e zbatimit të masave dhe raportimin e rezultateve.
6. Rishikimin e Strategjisë kur ndryshojnë kushtet institucionale ose kuadri ligjor.

Për zbatimin efektiv të Strategjisë mund të përgatitet një plan veprimi vjetor, në të cilin përcaktohen aktivitetet, përgjegjësitë, afatet dhe rezultatet e pritshme.

IV.2. Raportimi

Raportimi i risqeve realizohet sipas strukturës hierarkike dhe procedurave të miratuara në institucion.

Drejtuesit e strukturave raportojnë për risqet kryesore, ndryshimet e konstatuara, masat e ndërmarra dhe problematikat që kërkojnë vendimmarrje ose mbështetje shtesë.

Raportimi duhet të jetë i dokumentuar dhe të përmbajë informacion të mjaftueshëm për vlerësimin e gjendjes së riskut dhe të efektivitetit të kontrolleve.

Risqet që mund të kenë ndikim të rëndësishëm në objektivat strategjikë, në burimet publike ose në vazhdimësinë e veprimtarisë duhet t'i komunikohen pa vonesë strukturës përgjegjëse, sipas procedurave në fuqi.

IV.3. Rishikimi i Strategjisë

Strategjia rishikohet të paktën një herë në vit, si dhe kur ka ndryshime të rëndësishme në:

- Kuadrin ligjor dhe rregullator.
- Strukturën organizative të DPM-së.
- Objektivat strategjikë dhe operacionalë.
- Burimet financiare, njerëzore ose teknologjike.
- Proceset kryesore të institucionit.
- Profilin e risqeve dhe efektivitetin e kontrolleve.

Rishikimi synon të sigurojë që Strategjia të mbetet e përshtatshme, e zbatueshme dhe në përputhje me nevojat institucionale.

Ndryshimet e propozuara dokumentohen dhe i nënshtrohen miratimit sipas procedurave të institucionit.

IV.4. Hyrja në fuqi

Kjo Strategji hyn në fuqi pas miratimit nga Drejtori i Përgjithshëm i DPM-së dhe zbatohet nga të gjitha strukturat e institucionit.

Me hyrjen në fuqi, strukturat përgjegjëse marrin masat e nevojshme për njohjen e punonjësve me përmbajtjen e dokumentit dhe për zbatimin e detyrimeve që rrjedhin prej tij.

NËPUNËSI ZBATUES

Qëndrime Bregu